



Republika e Kosovës / Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt.
Data

26.10.2023

Vit.
gjin.

Punëtor i Sektorit të
Inspektoratit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:207586

Datë: 06.10.2023

Numri i dokumentit: 04762568

K.nr. 344/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, gjyqtari Gani Rugova, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit **Driton Osmani-N.P.T. IBOS**, njësia në rrugën "Skënderbeu" ne Istog, ne cilësi të personit fizik, për kundërvajtjen nga neni 15 par.1.2 sanksionuar nga neni 19 par. 13, nën par.13.3 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr.03/2022 për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme, e në bazë të nenit 55.2,77,86,124,127 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje me datë 05.10.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI, Driton Osmani- N.P.T. IBOS, ne cilësi të personit fizik të operatorit ekonomik njësia në rrugën "Skënderbeu" ne Istog, me numër biznesi 810292277,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Për shkak se me datë 27.09.2022, rreth orës 11:10 min., gjatë inspektimit të kryer nga ana e Inspektorëve të Inspektoratit të Tregut MINT, në Operatorin ekonomik N.P.T."IBOS" në Istog me pronar Driton Osmani, kanë konstatuar se është tejkaluar çmimi maksimal i lejuar për secilin produkt të naftës, ashtu që çmimin për benzinë ka qenë 1.33 euro ndërsa sipas kuponëve fiskal është faturuar 1.34 euro sipas përcaktimit të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për datën 27.09.2022 prej orës 10:00, i cili ka qenë valid 24 orë nga data dhe ora e publikimit ,

-me veprim të këtillë ka kryer kundërvajtje nga neni 15 par.1.2 sanksionuar nga neni 19 par. 13, nën par.13.3 të Ligjit Nr.08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe lidhur me nenin 26 të Ligjit nr.06/034 për Mbrojtjen e Konsumatorit e sanksionuar me nenin 137 pika 1.10 par 2, mbështetur në nenin 31,35 të LK-së , me aplikimin e dispozitave të përmendura,

DËNOHET

Me dënim gjorbë në shumë prej 400 (katërqind) €, të cilën gjorbë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, në të kundërtën do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 10 €, konform nenit 59,76 të LK-së, në të njëjtë afat sikurse dënimi.

A r s y e t i m

Inspektorati i Tregut-MINT, Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut për Naftë dhe Derivate të Naftës, me datë 28.09.2022, ka parashtruar gjykatës kërkesë me Nr.ref.19/2022, për fillimin e procedurës kundërvajtës, kundër të pandehurit **Driton Osmani- N.P.T. IBOS, ne cilësi të personit fizik të operatorit ekonomik, njësia në rrugën "Skënderbeu" në Istog, me numër biznesi 810292277**, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtës me marrjen në pyetje të pandehurit **Driton Osmani** cili deklaroi se Sa i përket datës 27.09.2022 ora 11:10 min., të cilët inspektorët në monitor kanë qene çmimin e benzinës 1.34 cent, e është dashur që të jetë 1.33 cent, për litër, ceku se për këtë ka qenë i angazhuar Menaxheri i pompës Metush Avdijaj, mirëpo i njëjti atë ditë nuk ka qenë prezentë për shkak të një rasti i cili është kthyer nga ora 12:00 dhe menjëherë e ka bërë përmirësimin, ceku se askush nuk di ta bejë përmirësimin me kompjuter përpos tij, dhe ky ka qenë shkak: ceku se ne si biznes gjithmonë ju kemi përmbajtur vendimit qeveritar, por atë ditë lëshimi është bërë vetëm për shkak të mungesës së menaxherit dhe atë vetëm të paradites, andaj, kërkojë nga gjykata që të ketë parasysh këto, dhe për shkak të kushteve dhe fitimit të vogël, të sanksionuar dhe nga Qeveria, të na liron nga dënimi apo të na shqiptojë një dënim më të butë, ku si biznes individual mbaj dhe 8 punëtor, dhe atë me vështirësi për shkak të gjendjes ekonomike.

Pranë kësaj gjykate është dëgjuar Inspektori i Tregut **Eljesa Beqiri**, i cili në dëshminë e tij deklaroi se: Më dt. 27.09.2022 ora 11.10, pikërisht kemi qenë në kontroll tek Operatori Ekonomik **NPT Ibos**, lidhur me vendimin e qeveris Ref nr. 01132 e dt. 30.08.2022, lidhur me çmimet e lejuara të shitjes me çmimin maksimal të shitjes me pakicë, me çka për datën 27.09.2022, sipas këtij vendimi të Qeverisë dhe njoftimit, ku benzina është dashur që të është për litër. 1.33 cent, ndërsa në monitor kemi gjetur 1.34 cent, një cent më shumë qe d.m.th, se **Driton Osmanaj**, në cilësinë e personit fizik, nuk ka respektuar këtë vendim, me çka ka bërë shkelje të Ligjit, 06/034, për mbrojtjen e konsumatorit.

Nga të dhënat e parashtruara sipas kërkesës së Inspektoratit të MINT, procesverbali nr.00673, të datës 27.09.2022, mbrojtjen e të pandehurit i cili pohon kundërvajtjen me të cilën ngarkohet, deklaratën e inspektorit të tregut të dhënë në gjykatë datë 28.09.2023, fotot e kuponëve fiskal të datës 27.09.2022, të cilës dëshmi i fali besim provues, andaj Gjykata pas administrimit të të gjitha provave veç e veç dhe në lidhshmërinë me njëra tjetrën, konstatoi se i pandehuri ka kryer veprë kundërvajtës të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për çka është shpallur përgjegjës dhe dënuar me gjorbë sipas Ligjit.

Me rastin e shqiptimit të gjobës gjykata mori për bazë rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me nenin 31 të Ligjit për Kundërvajtje, peshën e kundërvajtjes, rrezikshmërinë shoqërore të saj, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, i zotuar se nuk do ta përsërisim më një veprim të tillë apo të ngjashëm, andaj gjykata konform nenit 31 dhe 35 të LK-së, i shqiptoi sanksionin me gjobë, duke konsideruar se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit dhe shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
Nga një kopje të këtij aktgjykimit ti dorëzohet të pandehurës dhe parashtruesit të kërkesë.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG
Dep. i Përgjithshëm- Diviz. për Kundërvajtje
K.nr.344/2022, me datë 05.10.2023



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët në procedurë mundë ushtron ankesë Gjykatës së Apelit-Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes kësaj Gjykate.